



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:062982  
Datë: 21.01.2025  
Numri i dokumentit: 06732670

**C-IV.-18-0084**

*Paditësi:*

**Kosovska Banka DD.**  
*Përfaqësuar nga V K, avokat nga Beogradi, Serbi.*

*Kundër:*

*E paditura:*

**N.SH “Stacioni i Veterinarisë” – Gjakovë**, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.20 janar 2025, lëshon këtë:

### A K T G J Y K I M

**1.REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PEJ097-0017 i dt.02 korrik 2018, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

**2.Ankuesja lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore.**

#### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.18 gusht 2018, parashtruesja ka ushtruar kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) për rishqyrtim të vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. vendimeve të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PEJ097-0017 i dt.02 korrik 2018, të cilët i janë refuzuar kërkesa për kompensim të kredisë së pretenduar në shumë prej 720.84USD nga N.SH “Stacioni i Veterinarisë” – Gjakovë (në likuidim). Paditësja në padi ka deklaruar se dëshmitë që e mbështesin kërkesën gjenden në ish zyrën qendrore të Kosovska Banka në Prishtinë dhe se AL duhet të vepronte sipas nenit 48 të Ligjit për AKP-në dhe të dorëzonte kërkesë për udhëzime nga DHPGJS, si dhe DHPGJS të urdhëroj AKP-në dhe UNMIK-un të deklarohen se ku gjenden provat. Ankesës i ka bashkangjitur: Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Kopjen e kërkesës për informacion.

Me dt.24 shtator 2018, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në kërkesë, në të cilën pohoi se AKP e kundërshton në tërësi kërkesën e paditëses si të pa pranueshme në kuptim të nenit 28.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-033 të DHPGJS, pasi që paditësi është person juridik i cili deklarohet se është në falimentim dhe pretendon se përfaqësohet nga administratori i falimentimit Z B, e që në shkresa të lëndës nuk është ndonjë dokument që dëshmon se ky person është i emëruar si administrator i “Kosovska Banka” nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Në mungesë të këtij dokumenti AKP konsideron se paditësit i mungon legjitimitetit për të nisur procedurën. Parashtruesja e kërkesës nuk ka prezantuar fakte në të cilat e mbështet kërkesën e saj andaj, AKP konsideron se nuk ka dëshmi relevante që dëshmon se i takon e drejta e pretenduar. Tutje ka kërkuar që kërkesë e paditëses të refuzohet si e pa bazuar ose të hedhet poshtë si e pa pranueshme. Mbrojtjes i ka bashkangjitur kopjen e vendimit C-IV.-15-0841.

Me dt.26 tetor 2018, parashtruesja e kërkesës ka paraqitur përgjigjen e saj në mbrojtjen e AKP-së, ku ka deklaruar se pretendimi se administratorit të “Kosovska Banka” i mungon legjitimitetit është i pa saktë dhe jo serioz, ngase i njëjti është i emëruar me vendim të Agjencisë së Sigurimit të depozitave si administrator i falimentimit. Theksimet e saj në mbrojtje se nuk e di vendndodhjen e dokumentacionit për kërkesën e “Kosovska Banka” DD në falimentim, dhe se nuk është obligim ligjor i saj që të siguroj dokumentet, nuk qëndrojnë sepse ajo jo vetëm se e di vendndodhjen por edhe se i posedon dokumentet në fjalë. Andaj ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj kërkesën si të bazuar.

### **Arsyetimi ligjor**

Kërkesa për rishqyrtim të vendimit të AL-së refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuara), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Gjykata pasi ka shqyrtuar në tërësi pretendimet e palëve, gjen se çështje kontestuese është themelësia dhe vërtetësia e kërkesave të parashtruara para Autoritetit të Likuidimit dhe para Dhomës së Posaçme, por që ankuesi me asnjë provë nuk e dëshmon faktin se kërkesat e theksuara i takojnë dhe shumat janë të vërteta, po ashtu ankuesi përmes shkresave të dorëzuara edhe vet ka pohuar se nuk i posedon dëshmitë me anë të së cilave mbështeten kërkesat duke aluduar se dëshmitë gjenden në AKP.

Autoriteti i Likuidimit me vendimin PEJ097-0017 i dt.02 korrik 2018 e ka refuzuar plotësisht kërkesën e ankuesit me arsyetimin se paditëses ka dështuar të dorëzojë një kërkesë të plotë të argumentuar dhe të mbështetur në prova përkatëse dhe se ky dështim u përsërit edhe pas kërkesës për informacione shtesë që Autoriteti i Likuidimit i dërgoi parashtruesit.

Në lidhje me pretendimet e parashtrueses se AKP-ja posedon tërë dokumentacionin përkatës lidhur me bazueshmërinë e kërkesës dhe se Dhoma e Posaçme duhet të obligojë ti paraqes të njëjtat, gjykata vlerëson se një pretendim i tillë është i pa bazuar dhe në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, sipas të cilit “*palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”.

Dëshmitë e dorëzuara gjatë dhënies së përgjigjes ndaj mbrojtjes së AKP-së nga parashtruesja, nuk janë relevante në lidhje me bazueshmërinë e kërkesës, pasi që me asnjë provë nuk dëshmohet baza ligjore e kërkesës së pretenduar, kohën se kur ka lindur kërkesa, po ashtu është cekur vetëm shuma e përgjithshme e kërkesave, por nuk janë paraqitur informata se si janë përllogaritur ato shuma. Sipas nenit 23.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, përcaktohen informatat që duhet ti përmbajë formulari i kërkesës lidhur me ndonjë të drejtë kreditore, por që në rastin konkret parashtruesi i kërkesës ka dështuar që ti përmbahet këtyre kushteve, duke mos paraqitur ndonjë dokument bazë para Autoritetit të Likuidimit por edhe para Dhomës së Posaçme, me të cilin do të plotësoheshin kriteret e parapara me nenin e lartcekur dhe me të cilin do të dëshmonte vërtetësinë dhe vlefshmërinë e kësaj kërkesë.

Po ashtu sipas nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme (Ligji nr. 04/L-033), pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese). Me fjalë të tjera, kushto që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*). Në këtë rast ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se i takon e drejta e pretenduar. Gjykata gjen se në mungesë së dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kërkesat kreditore në shumën prej 720.00USD nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par..4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Në pajtim me nenin 13 par.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr.01/2017, ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, pasi që vlera e kontestit është nën 1.000€.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a  
**Hajrie Shala**